



QENDRA PËR
KËSHILLIM NË
KARRIERË
PRISHTINË



QENDRA PËR KËSHILLIM NË KARRIERË KOMUNA E PRISHTINËS

Zbulo veten/Shfrytëzo potencialin/Realizo ëndrrën



British Embassy
Pristina

PARTNERËT: Ky publikim është mundësuar nga Ambasada britanike në Prishtinë, në kuadër të projektit "Themelimi i Qendrës për Këshillim në Karrierë", i cili ka për qëllim që t'i ndihmojë të rinjtë e shkollave profesionale të komunës së Prishtinës, për t'i arritur aspiratat dhe për të qenë sa më të suksesshëm në karrierë.



QENDRA PËR
KËSHILLIM NË
KARRIERË

PRISHTINË

QENDRA PËR KËSHILLIM NË KARRIERË

Qendra për Këshillim në Karrierë është themeluar në mars të vitit 2015, me iniciativë të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti. Qendra krijon parakushte për lidhjen e shkollave të arsimit dhe aftësimit profesional (SHAAP) me sektorin privat, që do të kontribuonte te studentët e SHAAP-së në ndërtimin e efektshmërisë ndërpersonale, rritjen e mundësive për karrierë, përmirësimin e tregtueshmërisë së punësimit, promovimin e gjetjes efektive të vendit të punës dhe përforcimin e marrëdhënieve me punëdhënësin.

Roli i Qendrës për Këshillim në Karrierë

Qendra për Këshillim në Karrierë e Komunës së Prishtinës, do të luajë rol vendimtar në përforcimin e lidhjeve në mes të sektorit privat dhe SHAAP-së . Qendra do t'u ofrojë nxënësve të SHAAP-së mundësitë për të fituar njohuri, aftësi dhe përvojën e duhur për të identifikuar opsionet, për të shqyrtuar alternativat në tregun e punës dhe për të pasur sukses në shoqëri.



SHËRBIMET PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE PROFESIONALE

KËSHILLIM DHE ORIENTIM NË KARRIERË

Këshillim dhe orientim në karrierë
Qendra do t'u ndihmojë që t'i njihni më mirë: interesat tuaja, prirjet, shkathtësitë e dalluara, personalitetin tuaj, si dhe rrethanat dhe tregun e punës, përmes të cilave do t'ju orientojë në karrierë. Në këtë mënyrë, ju do të mund të zgjidhni rrugën e duhur profesionale dhe të bëni hapat e nevojshëm për të zhvilluar më tej karrierën tuaj. Kjo do të bëhet përmes këshillimeve individuale dhe grupe për orientim në karrierë.

Në këto trajnime nxënësit mësojnë për:
përgatitjen e CV-së, letrës motivuese,
teknikat e intervistës, rregullat e sjelljes në
organizatë, rrjetëzimin me kompani, mënyrën
e kërkimit dhe aplikimit për vende të lira të
internshipit dhe punës.

TRAJNIME PËR ZHVILLIMIN E SHKATHTËSIVE TË BUTA

INFORMIM DHE ASISTIM NË GJETJEN E INTERNSHIPIT DHE PUNËS

Me qëllim të rritjes së nivelit të punësimit tek të rinjtë, Qendra e karrierës organizon ngjarje të ndryshme, ku marrin pjesë bizneset dhe të diplomuarit e shkollave profesionale, me qëllim të promovimit të shkollave profesionale, komunikimit interaktiv në mes të dy palëve, rrjetëzimit dhe bashkëpunimit.

Përmes shfrytëzimit të data-bazës së kontakteve, rrjetit të kompanive me të cilat qendra bashkëpunon dhe informatave në lidhje me kuadrin e kërkuara nga tregu, qendra do t'i ndihmojë nxënësit për t'u ndërlidhur me kompani të profileve të ndryshme që i përshtaten profesionit të tyre.

ORGANIZIM I NGJARJEVE PËR GJETJEN E PUNËS PRAKTIKE DHE PUNËSIM

KURSE PLOTËSUESE PROFESIONALE

Për t'i zhvilluar më tej kapacitetet e nxënësve të shkollave profesionale dhe për të rritur mundësitë e tyre për punësim, Qendra angazhohet që të organizojë kurse plotësuese profesionale për nxënësit, të cilat kurse do të jenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.

Përpos aktiviteteve të përmendura më lart, në ueb-faqen e Qendrës nxënësit do të mund t'i qasen materialeve të ndryshme, të cilat mund t'i ndihmojnë ata në përcaktimin e profesionit dhe hapat që duhet ndjekur për zhvillim të karrierës.

LITERATURË PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS



SHËRBIMET QË OFROHEN
PËR NXËNËSIT
E SHKOLLAVE FILLORE

Për t'u ndihmuar sa më shumë nxënësve të shkollave fillore, gjegjësisht klasave të nënta, të cilët janë në prag të përzgjedhjes së profesionit apo drejtimit për shkollim të mesëm, Qendra, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, organizon teste të ndryshme, përmes të cilave mundësohet njohja e talenteve dhe interesave të fëmijëve në lidhje me profesionin. Përveç kësaj, Qendra ofron informata për profilet profesionale që mund të studiohen në shkollat profesionale, si dhe organizon vizita për nxënësit në kompani të ndryshme për t'u njoftuar më mirë me profesione të caktuara.



SHËRBIMET QË OFROHEN
PËR BIZNESET

Qendra për Këshillim në Karrierë, u mundëson kompanive që, në mënyrë më të lehtë dhe të shpejtë, të gjejnë praktikantë dhe punëtorë, pa pasur nevojë që të kalojnë nëpër procedura, të cilat zakonisht marrin kohë dhe janë të kushtueshme për kompanitë.

Qendra ndërmjetëson dhe lehtëson komunikimin në mes të studentëve dhe kompanive për t'i sistemuar praktikantët e nevojshëm në kompani. Përveç kësaj, Qendra bën marrëveshje me kompanitë, të cilat janë të interesuara dhe kanë potencial për t'i punësuar të diplomuarit në shkollat profesionale.

Shërbimet për biznese

Angazhim të praktikantëve dhe punëtorëve:

- Angazhim të kandidatëve të talentuar për nevojat e kompanisë suaj;
- Seleksionim dhe intervistim të kandidatëve për punë praktike/punësim;
- Vlerësim i eksperiencës nga puna praktike, sipas metodologjisë së punës të zhvilluar nga Qendra për Këshillim në Karrierë;
- Organizim të panairëve, që kanë për qëllim punësimin dhe punën praktike;

- Organizim të ngjarjeve, me qëllim të promovimit dhe adresimit të kërkesave të tregut për profesionet e caktuara.

Shërbime konsultative dhe trajnime:

- Trajnim për organizim të suksesshëm të punës praktike, në bazë të metodologjisë së adoptuar "Këshillim për karrierë për kompanitë";
- Konsultim dhe mentorim për menaxhim me burimet njerëzore brenda kompanisë.

Shërbime të promovimit:

- Krijimi i profilin tuaj në portalin e Qendrës për Këshillim në Karrierë;
- Promovim i kompanisë dhe produkteve/shërbimeve;
- Postim i lajmërimeve për punë praktike/punësim.

Bashkëpunimi me Qendrën për Këshillim në Karrierë u mundëson:

- Qasje të shpejtë dhe efektive në gjetjen e praktikantëve dhe fuqisë punëtore;
- Ofrim të kandidatëve të cilët kanë njohuri

dhe shkathtësi që përputhen me kërkesat e kompanisë;

- Qasje të kandidatëve të cilët kanë kryer punë praktike dhe lehtë mund të adaptohen në ambientin e punës;
- Ofrim të kandidatëve të cilët kanë potencial dhe talent për të qenë të suksesshëm në profesion e tyre;
- Kandidatë të cilët posedojnë shkathtësi të larta të komunikimit, organizimit, bashkëpunimit, punës ekipore dhe sjellje të duhura për t'u përshtatur me ambientin e punës;
- Fuqi punëtore të lirë, me mundësi të identifikimit të talenteve të reja, pa risk dhe kosto të lartë;
- Kandidatë të cilët mund të sjellin koncepte dhe ide të reja për biznesin.

Prishtinë
Rruga: Hilë Mosi, Nr.11
www.qendraekarrieres.com
info@qendraekarrieres.com
facebook.com/keshillimnekarriere

